VENDIM
Nr. 160, datë 5.6.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "NEXORA ENERGY" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1660/1 prot., datë 3.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Nexora Energy' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Nexora Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1660 prot., datë 22.5.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për pikën 1.1, germat: "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat: "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3 germat: "a", "b" dhe "c"; si dhe pikën 2.5.
- Në lidhje me stafin teknik që do të angazhohet me veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, shoqëria ka bërë me dije se stafi do të jetë efektiv në fazën e dytë, pas marrjes së licencës. Në këto rrethana vlerësohet t'i bëhet me dije shoqërisë që në rast licencimi, do t'i lihet kushti përkatës për përditësimin e informacionit mbi stafin efektiv të angazhuar në ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Nexora Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti